



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK VLORË

Nr. 406 Prot.

Vlorë, më 14.052025

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

Drejtuar: **DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE**
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

TIRANË

Në zbatim të Ligjit Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”; të Ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; të Udhëzimit Nr.759, datë 30.09.2024 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë, menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”, të Urdhërit Nr.139, datë 28.01.2025 “Për miratimin e strukturës dhe të organikave të Qendrave të Formimit Profesional Publik” dhe të Urdhërit Nr.317, datë 11.03.2025 “Për një ndryshim në Urdhërin Nr.139, datë 28.01.2025 “Për miratimin e strukturës dhe të organikave të Qendrave të Formimit Profesional Publik”;

Qendra e Formimit Profesional Publik Vlorë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- 1 (një) specialist në Sektorin e Financës për QFPP Vlorë;

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vendin e lirë si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë të paktën diplomë të nivelit Bachelor, në shkenca ekonomike;
- b) të ketë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në fushën në të cilën është kualifikuar;
- c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin;
- b) jetëshkrimin (CV-në)
- c) kartën e identitetit;
- d) diplomën;
- e) librezën e punës;
- f) çdo dokument tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet e të tjera të përmendura në CV;
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- j) vërtetimin nga punëdhënësit i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e Qendrës së Formimit Profesional Publik Vlorë, brenda datës 30.05.2025

DREJTOR
ERGYS ALLUSHI

